



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1288/3 Prot.

Pogradec, më 19.03, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues për: *“Përjashtimin e përkohshëm nga tarifat vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Zonën historike A, për t’i dhënë mundësi zhvillimi kësaj zone”*.

Me respekt,

KRYETARI


Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROJEKT – VENDIM
NR. ____, DATË ____ . ____ .2026
PËR

“PËRJASHTIMIN E PËRKOHSHËM NGA TARIFAT VENDORE PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË AKTIVITET NË ZONËN HISTORIKE A, PËR T’I DHËNË MUNDËSI ZHVILLIMI KËSAJ ZONE”.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023 për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”, i ndryshuar, relacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin e përkohshëm nga tarifat vendore për subjektet me xhiro vjetore 0-2 milion lekë, që ushtrojnë aktivitetet në zonën “Naim Frashëri” dhe “Topleci”, përveç kategorisë “Profesione të lira” dhe kategorisë “Për çdo subjekt ndërtimi, shërbime në ndërtim, materialesh inerte, miniera me aktivitetet në territorin e qytetit /Njësi Administrative”, për t’i dhënë mundësi zhvillimi zonës.
2. Përjashtimi nga tarifat vendore do të zbatohet për periudhën, nga data 01.06.2026 deri në datën 01.06.2028.
3. Për zbatimin e këtij vendim ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. 1288/prot.

Pogradec, më 19.03.2026

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin për “Përfundimin e përkohshëm nga tarifave vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Zonën historike A, për shkak të zhvillimit të punimeve publike”.

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë!

Në qendrën historike dhe zonën e mbrojtur të qytetit të Pogradecit, po zhvillohen punime publike që lidhen me rikualifikimin urban të dy zonave historike "Topleci" dhe "Naim Frashëri". Këto ndërhyrje synojnë përmirësimin e infrastrukturës urbane, rritjen e potencialitetit turistik dhe kulturor, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, veçanërisht të turizmit familjar dhe shërbimeve për vizitorët.

Deri tani kjo zonë nuk ka zhvillimin që i takon për shkak të infrastrukturës.

Bashkia Pogradec vlerëson të nevojshme ndërmarrjen e një mase lehtësuese të përkohshme për subjektet e vogla (me qarkullim vjetor 0-2 milion lekë), me qëllim për t'i ndihmuar këto biznese dhe për t'i dhënë oportunitet zhvillimi kësaj zone.

Kjo masë konsiston në përfundimin e tyre nga pagesa e tarifave vendore për një periudhë 2 vjeçare.

Nga analizimi i pasojave të efekteve ekonomike të veprimtarisë së bizneseve është menduar që të mos përfshihen në lehtësim kategoritë e subjekteve që ushtrojnë veprimtari “Profesione të lira si Avokat, Noter, Arkitekt, Inxhinier, Projektues, Ekonomist, Agronom, Ekspert Kontabël, Mjek i Specializuar, Stomatolog, Stomatolog i Specializuar, Farmacist, Infermier, etj” dhe kategoria “Për çdo subjekt ndërtimi, shërbime në ndërtim, materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit /Njësi Administrative”, pasi këto kategori kanë funksionuar normalisht edhe pse në zonë janë zhvilluar punime.

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se në këtë zonë ushtrojnë aktivitetet një numër i vogël subjektësh.



Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) *Akte administrative me karakter normativ*
- 2) *Akte administrative me karakter individual*
- 3) *Akte administrative me karakter kolektiv*

Sipas përcaktimit të nenit 13, pika 2, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, ligji 197/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Më tej, ky ligj në nenin 8, shkronja “a”, përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, proçedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak, do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë, për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji u ka njohur ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i proçedurës administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: “Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.

Neni 3, pika 1, shkronja “a”, e ligjit 44/2015 “Kodi i proçedurës administrative”, jep këtë përkufizim për “Aktin administrativ”:

a) “**Akti administrativ individual**” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “**Akti administrativ kolektiv**” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar

individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete; Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që i drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij projekt vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit 44/2015 "Kodi i procedurës administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili nuk është shteruar në zbatimin e tij dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike kundrejt një numri të pacaktuar subjektsh, të cilët ushtrojnë aktivitetet në zonën e përcaktuar dhe vetëm për një periudhë të caktuar.

Ky akt ka karakter të përgjithshëm dhe të përkohshëm, pasi zbatohet për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitetet në zonën e përcaktuar dhe vetëm për një periudhë të caktuar.

Përfundimish konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

**Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.
Faleminderit!**

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Klajdi Bizgjoni
Pranoi: Anxhela Piliçi
Miratoi: Paskalino Ziko
Konfirmoi: Dritan Babasuli

Interpretoi karakterin e aktit juridik:

Jurist i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore: Esmeralda Topçiu

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**

